



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇE

**RISHPALLJE PËR
PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

**Lloji i diplomës “Ekonomi (ekonomiks,
menaxhim, financë, kontabilitet, marketing)”,
niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”.**

Në kushtet kur në përfundim të zhvillimit të procedurës së rekrutimit nga jashtë shërbimit civil, Komisioni i Përhershëm i Pranimit, në bazë të VKM nr. 143, datë 12.3.2014, vendosi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pa asnjë të përzgjedhur Bashkia Korçë në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut IV, pika 15 të Vendimit nr. 143, datë 12/03/2014, të Këshillit të Ministrave, rishpall procedurat e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Rregjistrimit, në Drejtorinë e të Ardhurave, në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontroll Territorit- kategoria e pagës III-b.
- 2 (dy) Specialist për liçensimin e subjekteve të biznesit në Sektorin e Rregjistrimit, në Drejtorinë e të Ardhurave, në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontroll Territorit- kategoria e pagës III-b.
- 1 (një) Specialist për menaxhimin e borxhit të keq në Sektorin e Rregjistrimit, në Drejtorinë e të Ardhurave, në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontroll Territorit- kategoria e pagës III-b
- 1 (një) Specialist për mbledhjen e taksës së tregut në Sektorin e Tregjeve në Drejtorinë e të Ardhurave, në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontroll Territorit - kategoria e pagës III-b

**Për procedurat e rishpalljes për pranim në shërbimin civil në
kategorinë ekzekutive, afati i aplikimit është 15 ditë!**

Afati për dorëzimin e dokumentave: 06.02.2015

Përshkrimi përgjithësues i punës për grupin e pozicioneve si më sipër është:

Përgjegjës për parashikimin, mbledhjen dhe supervizimin në mënyrë efiçente dhe periodike, të të ardhurave që rrjedhin drejt institucionit Bashkia Korçë nga subjektet që i nënshtrohen sistemit fiscal vendor.

I- Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

- c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);

dh) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen nëpërmjet shërbimit postar ose dorazi në Institucionin e Bashkisë Korçë

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë ose në institucion duhet të bëhet brenda datës 06.02.2015

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e ekonomisë;
- Njohuritë mbi Ligjin 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- Njohuritë mbi Ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
- Njohuritë mbi ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
- Njohuritë mbi Ligjin 10 279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Korçë, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Korçë duke filluar nga data 13.02.2015